




KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



academy for leadership democratization & integration
akademija za liderstvo demokratizaciju & integraciju

MEMORANDUMI BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. ALDI, Adresa Fsh. PLANJANE p.n. 20530 Reqane/ Prizren, të cilën e përfaqëson Ma. Zahir Arifovic

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe OJQ ALDI, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Ojq ALDI do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi ojq ALDI në aspektin e mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit si dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të saj, me programet e saj arsimore në të gjitha nivelet.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë, ojq ALDI me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomis dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet ojq ALDI.

Neni 4
Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5
Kopjet e Memorandumit



Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6
Hyrja në fuqi



Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALET NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë


/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/


OJO ALDI
Drejtor Ekzekutiv


/Ma. Zahir Arifoviq/


Nënshkruar në Prishtinë, me datë 11/07/2018